

VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi Nr. 2022-001

Data: 19.01 2022

Pjesëmarrja e Arian Ibrahimit në Level 3

Bordi me shumicë votash ka aprovuar propozimin nga ITF që trajneri Arian Ibrahimit të marr pjesë në kursin teknik për trajner të tenisit të nivelit 3 që organizohet nga Federata Botërore e Tenisit në Valencia.

Vendimi Nr. 2022-002

Data: 31.01.2022

Ndryshimet e selektorëve për pjesëmarrje në Development Championships 2022

Pas pamundësisë së pjesëmarrjes së selektorit Lorik Haxhishabani në Development Championships 2022, bordi me shumicë votash merr vendim që selektori Arian Ibrahimit të kalojë në grupmoshën U12 ndërsa trajneri Meldin Mustafi të përfaqësojë kategorinë U14 në Development Championships 2022, që mbahet nga data 24 shkurt – 7 Mars në Antali.

Ky vendim vlen vetëm për aktivitetin Development Championships 2022.

Vendimi Nr. 2022-003

Data: 03.12.2021

Propozimet në KOK për Bursa Olimpikë 2022

Bordi me shumicë votash merr vendim që të nominojë tenistët Vesa Gjinaj, Aja Broqi dhe Fresk Sylhasi për Bursa Olimpikë të vitit 2022, bazuar në përmbushjen e kërkesave/ kriterëve të përcaktuara nga KOK për thirrjen në fjalë.

Administrata e FTK-së do të i nominojë të lartëpërmendurit, ndërkohë që përzgjedhja do të jetë përgjegjësi e KOK.



Vendimi Nr. 2022-004

Data: 04.02.2022

Propozimet në KOK për Laureatë 2021

Pas thirrjes së KOK për të nominuar sportisë për Laureatët 2021, bordi me shumicë votash merr vendim të nominojë tenisten Vesa Gjinaj për kategorinë Shpresa Olimpike 2021.

Laureatët do të shpallën nga KOK më 03 Mars 2022.

Vendimi Nr. 2022-005

Data: 11.02.2022

Training Week - Mouratoglou Academy

Bordi me shumicë votash merr vendim të nominojë tenisitin Unik Ramadani për pjesëmarrje në kampin Mouratoglou Academy që organizohet në bashkëpunim me Tennis Europe.

Nominimi do të i dërgohet Tennis Europe për pjesëmarrjen e Unikut në këtë kamp të ushtrimeve për qëndrim 1 javor në tetor 2022.

Shpenzimet e këtij aktiviteti do të mbulohen në terrësi nga Mouratoglou Academy.